



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/05-122687/25, më 15 AUG 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet caktimi i organit mbikëqyrës për *“Kontratën në shtëpi për rregullimin e oborreve, sipërfaqeve gjelbëruese në institucionet edukativo-arsimore”* e lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe NPL “Gjelbër” Sh.A. me nr. 14-024/01-114320/25 e dt. 05.08.2025.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, anëtarë të organit mbikëqyrës janë:
 1. Ridvan Islami, menaxher i kontratës, Drejtoria e Arsimit;
 2. Ardiana Ismaili, mbikëqyrëse e kontratës, Drejtoria e Arsimit.
3. Detyrat dhe punët e organit mbikëqyrës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi janë: Mbikëqyrja e kontratës, pranimi i faturave dhe konstatimi i punëve të kryera nga NPL “Gjelbër” dhe ndërmarrja e veprimeve sipas obligimeve të përcaktuara në kontratë.
4. Për kryerjen e punëve si në pikën 3 të këtij Vendimi, organi mbikëqyrës do t’i raportoj Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të organit mbikëqyrës;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

